



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Kodi 242

**SHPLLJE PËR
LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Specialist në Shkenca Ekonomike, “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të kreut II, III, IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, Instituti i Statistikave, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e Statistikave të Popullsisë në Drejtorinë e Statistikave Sociale, klasa e pagës IV-1.
- 1 (një) Specialist në Sektorin e Statistikave të Konsumit të Familjeve në Drejtorinë e Statistikave Sociale, klasa e pagës IV-1.

Pozicionet më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakante, ato janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **18 Nëntor 2024**

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: **23 Nëntor 2024**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

Specialisti përgjigjet tek Përgjegjësi i sektorit për ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të vërtetimit të ndryshme dhe burimeve administrative sipas kalendarit të aktiviteteve. Harton pyetësorë specifikë për çdo anketë në përputhje me rregulloret e EU për treguesit e kërkuar.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shfrytëzon të dhënat administrative të nevojshme për treguesit e statistikave sociale në kuadrin e praktikave dhe procedurave të parashikuara në PSZ dhe planin operacional të punës me qëllim që të përmbushet misioni i sektorit.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë ekzekutive;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të ketë arsim të lartë në Shkenca Ekonomike, niveli “Master Profesional”. Edhe diploma Bachelor të jetë në të njëjtat fusha.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit dhe kërkesa për aplikim;
 - b- Fotokopje të diplomës
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brenda datës **18 Nëntor 2024**.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20 Nëntor 2024**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin e Statistikave, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr.17/2018 “Për statistikën zyrtare”,
2. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”,
3. Njohuri mbi Ligjin e Cens, Nr.140/2020 "Për Cens e Popullsisë dhe Banesave" - <https://www.instat.gov.al/media/8147/ligji-per-censin-nr-140-dt-26112020.pdf>
4. Njohuri mbi fushën e Statistikave Demografike dhe Sociale - <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/>
5. Njohuri mbi rregulloren e bashkimit Evropian mbi statistikën demografike - <https://eurlex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32013R1260>
6. Njohuri mbi rregulloren e Parlamentit Evropian, Nr.1700/2019, mbi përcaktimin e një kuadri rregullator të përbashkët, të statistikave të popullsisë dhe familjeve (SILC, ICT, ABF,etj) – <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/1700/oj>
7. Njohuri mbi Sistemin e Klasifikimeve dhe Nomenklaturat ndërkombëtare mbi Statistikat Sociale (COICOP, ISCED, NACE, etj).

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin e Statistikave do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe standat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe standat e informimit të publikut duke filluar nga data **10 Dhjetor 2024**.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të ketë arsim të lartë në Shkenca Ekonomike, niveli “Master Profesional”. Edhe diploma Bachelor të jetë në të njëjtat fusha.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kerkesa për pozicionin e kërkuar
 - b- Jetëshkrim i aplikantit;
 - c- Fotokopje të diplomës;
 - d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
 - h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet
 - i- pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brenda datës **23 Nëntor 2024**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **10 Dhjetor 2024**, Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të internetit të INSTAT, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbim civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Institutit të Statistikave, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **10 Dhjetor 2024**.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al